



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 6775

BASHKIA FIER  
KËSHILLI BASHKIAK

Date 28.05.2026

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. 53 Datë 28/05/2026

**"Për dhënien e Titullit "Qytetar Nderi" (pas vdekjes dhe në gjallje) për anëtarët themelues të "Grupi i Këngës Qytetare Fierake".**

Në mbështetje të Nenit 9, Pika 1.7 Shkronja "a", Nenit 54, Shkronja "m" të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, si dhe Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Këshillit Bashkiak Fier;

Duke marrë në konsideratë propozimin e Shoqatës "Bashkimi i Fierakëve në Greqi – Apollonia" (Protokolluar me Nr. 13030 Datë 14/11/2025) si dhe propozimin e Grupit Politik të PSD-së (Protokolluar me Nr. 5029, Datë 21/04/2026) për vlerësimin e personaliteteve të artit dhe kulturës fierake.

Pas shqyrtimit të raportit dhe rekomandimit të Komisionit të Arsimit, Sportit, Kulturës, Trashëgimisë Kulturore dhe Titujve të Nderit, Grupi I Këshilltarëve:

**PROPOZON:**

1 Dhënien e Titullit "QYTETAR NDERI" të Qytetit të Fierit, për kontributin e jashtëzakonshëm në ruajtjen, përcjelljen dhe promovimin e traditës së muzikës popullore qytetare fierake brenda dhe jashtë vendit, duke u shndërruar në identitet kulturor të qytetit, për personalitetet si më poshtë:

- Z. Jani Tase (Muzikant, Fisarmonikë) – Pas vdekjes
- Z. Miti Nushi (Solist) – Në gjallje
- Z. Llazar Pove (Dajre) – Në gjallje
- Z. Viron Konomi (Klarinetë) – Pas vdekjes
- Z. Ylli Xherai (Violinë) – Në gjallje
- Z. Agron Borova (Llahutë) – Në gjallje

1 Dorëzimi i titujve dhe dekoratave përkatëse të bëhet në një ceremoni zyrtare të organizuar nga Bashkia Fier në bashkëpunim me Këshillin Bashkiak.

2 Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Fier për zbatimin e këtij vendimi.

## PROPOZUESI

### GRUPI I KËSHILLTARËVE

Elida Sopoti

Kreshnik Dapi

Melsi Bogdani

Fatbardha Merkaç

Marjush Voja

Arben Çuko

Endri Jaupaj

Rrapi Gjika

Brunilda Hoxha

